

Nr. 884/1
29.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 463/1 prot.

Gjirokastrë, më 21.05.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË
Tepelenë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 31, datë 29.4.2026, “Për rmiratim të kërkesës për heqje dorë nga pasuria me status juridik ‘Në përdorim të Bashkisë Tepelenë’, me numër pasurie 3/1-A, ZK 3574 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 1358, sipas VKM nr. 6, datë 06.01.2011, ‘Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë’, fusha e përdorimit prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)”, në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’ nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 32, datë 29.4.2026, “Për miratimin në parim të zhvillimit të agroturizmit në sistemet bujqësore dhe natyrore sipas shprehjeve të interesit në tokat e dhëna me

qira nga Bashkia Tepelenë”, në parim konfirmohet, duke respektuar legjislacionin në fuqi në fushën e bujqësisë, natyrës, mjedisit, pyjeve e kullotave, zonave të mbrojtura, të trashëgimisë kulturore, etj. sipas territorit specifik, si dhe duke marrë konfirmimin nga institucionet përkatëse, siç e përcakton vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 12, datë 27.2.2019, ‘Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (ub), bujqësor (b) dhe natyror(n)’, i ndryshuar.

3. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 34, datë 29.4.2026, “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit të disa drejtorive të Bashkisë Tepelenë”, konfirmohet.

4. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 35, datë 29.4.2026, “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Tepelenë”, konfirmohet.

5. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 36, datë 29.4.2026, “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake Tepelenë”, konfirmohet.

6. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 37, datë 29.4.2026, “Për miratimin e nivelit të pagave të njësive administrative të Bashkisë Tepelenë”, konfirmohet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

